



2024

BULETINI

SHKURT



Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti, ka pritur në zyrën e tij 16 vjeqaren nga Poturovci Enilda Zeqiri një super talente e shumë fushave në sport, kryesisht në fushën e atletikës.

Enilda Zeqiri, seniore e atletikës e cila ka përfaqësuar Kosovën në shumë gara ka fituar mbi 20 çmime e trofe të ndryshme kryesisht ne vendin e parë.

Kryetari Imri Ahmeti ka uruar Enilden për sukseset e arritura në sport posaçërisht në fushën e atletikes, në të njëjtën kohë Kryetari Ahmeti i ka premtuar asaj vazhdimin e përkrahjes institucionale si dhe çdo sportisti tjetër që i sjell trofe dhe rezultate të mira Lipjanit.



Me rastin e përvjetorit të rënies së Dëshmorit, Xhevdet Breznica, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi me bashkëpunëtorë, kanë nderuar jetën dhe veprën e tij duke bërë homazhe pranë lapidarit në fshatin Dobrajë të Madhe.





Me rastin e ditës botërore të mbulesës e cila shënohet në mbarë botën, në sallën e Kuvendit të Komunës organizuar nga Departamenti i Gruas pranë Bashkësisë Islame në Lipjan, u zhvillua konferenca e dytë kushtuar mbulesës me moton “#veiledinstrength”.

“Ne çdo ditë angazhohemi për një shoqëri të prosperuar dhe demokratike, ku respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Komuna e Lipjanit është një shembull shumë i mirë i tolerancës fetare dhe gratë me mbulesë në Lipjan, gëzojnë trajtim të barabartë dhe pa diskriminim”, është shpreh nënkryetari Bytyqi.





Në palestrën e re të sportit në Lipjan është zhvilluar ndeshja miqësore ndërmjet KV Skënderbeut dhe KV Ulpiana në voleyboll

Në atmosferën e freskët të palestres së re të sportit në Lipjan, KV Skënderbeu dhe KV Ulpiana krijuan një ambient të jashtëzakonshëm duke dhuruar spektakël në lojën e voleybollit.

Palestra e re e sportit në Lipjan, do të jetë qendra e ngjarjeve sportive të ekipeve lipjanase, tani ekipet sportive dhe sportistët të cilët do ta shfrytëzojnë këtë palestër do të kenë një ambient brilant dhe motivues për arritjen e sukseseve në garat e ndryshme të sportit.




#	Komuna	Përmbledhje e rezultateve			
		Qeverisja demokratike	Menaxhimi komunal	Ofrimi i shërbimeve	Totali i pikëve
1	Deçan/Deçane	18	16	15	49.00
2	Dragash/Dragaš	10	12	6	28.00
3	Ferizaj/Uroševac	0	0	0	0.00
4	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	13	7	18	38.00
5	Gjakovë/Đakovica	29	14	14	57.00
6	Gjilan/Gnjilane	21	13	16	50.00
7	Gillogovc/Glogovac	33	23	18	74.00
8	Gračanica/Gračanicë	14	16	2	32.00
9	Hani i Elezit/Elez Han	32	17	9	58.00
10	Istog/Istok	29	13	14	56.00
11	Junik/Junik	29	16	21	66.00
12	Kaçanik/Kaçanik	29	16	10	55.00
13	Kamenicë/Kamenica	29	22	11	62.00
14	Klinë/Klina	22	11	16	49.00
15	Klokot Vrbovac/Kilokot Vërbovc	0	0	0	0.00
16	Leposavić/Leposaviq	0	0	0	0.00
17	Lipjan/Lipljan	35	18	22	75.00
18	Mališhevë/Mališevo	21	7	11	39.00
19	Mamushë/Mamuša	2	12	9	23.00

Në raportin e vlerësimit final të përformancës për vitin 2022 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Komuna e Lipjanit është e vlerësuar në vendin e parë nga vlerësimi për 29 treguesit e përformancës komunale.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka potencuar se progresi i komunës tonë, është arritje e të gjithë qytetarëve lipjanas.
Urime qytetar!

Figura 1: Performanca e përgjithshme në 29 tregues të GPK-së sipas komunave në përqindje





Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me Drejtorin e Bujqësisë z. Rexhep Rexhepi kanë vizituar një nga fermate blegtorisë

Gjatë kësaj vizite Kryetari z. Ahmeti ka potencuar se së shpejt do të filloj me subvencionimin për fermerët me 0.4 cent për litër qumështi dhe se këto ditë pritet të shpallet thirrja publike nga Komuna e Lipjanit për të gjithë fermerët prodhues të qumështit.

Kryetari z. Imri Ahmeti ka thënë se me këtë po fillojmë të mbështesim edhe këtë kategori të fermerëve me qëllim të nxitjes së prodhimit të qumështit dhe në të njëjtën kohë do të vazhdojmë edhe me mbështetjen e kategorive të tjera të sektorit të bujqësisë.





Në prag të 15 shkurtit Ditës së Flamurit të komunitetit të Ashkalijve të Kosovës, në ambientet e Bibliotekës së qytetit të Lipjanit është mbajtur një tryezë pune e organizuar nga Këshilli i Evropës/Bashkimit Evropian, ROMACTED II në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit lidhur me Zgjerimin e njohurive mbi identitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka uruar festen e flamurit komunitetit ashkalinjë dhe ka potencuar përkushtimin e qeverisjes lokale për përfshirjen dhe mbështetjen e të gjitha komuniteteve në territorin e Lipjanit. Ai po ashtu ka shprehur vullnetin e mirë për të punuar edhe më shumë drejtë qëllimeve të përbashkëta, për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit pa dallim.





FOTOLAJM/ Në kuadër të aktiviteteve për nderë të festës së Pavarësisë së Kosovës në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani”, në Lipjan është zhvilluar një program kulturo-festiv nga shkollat fillore të qytetit të Lipjanit.





Në kuadër të aktiviteteve për nderë të 16-të vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Komunën e Lipjanit e kanë vizituar një grup nxënësish të klasës së parë të shkollës fillore “Ismail Luma”, në Lipjan.

Nxënësit kanë takuar Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Lipjanit z. Daut Azemi, drejtorin e DKA-së z. Rasim Hasani dhe drejtoreshën e DKRS-së znj. Anila Reçica.

Përfaqësuesit komunal u kanë uruar fëmijëve 16 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, duke ju thënë se fëmijët janë motivi i së ardhmes dhe se çdo herë institucionet lokale mundohen të ju sigurojnë atyre siguri dhe hapësire në realizimin e arritjeve dhe synimeve të tyre.





Në Bibliotekën e qytetit në Lipjan në nderim të 16-të vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, u organizua një ekspozitë me piktura të krijuara nga nxënësit e shkollave fillore të qytetit. Në ekspozitën e hapur sot mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës, z. Diamant Bytyqi me bashkëpunëtorët e tij.

Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve u organizua edhe një orë letrare me shkrimtarët të cilët falë mbështetjes financiare nga Komuna e Lipjanit u është mundësuar botimi i veprave të tyre. Kjo iniciativë thekson rolin e komunës në promovimin e artit dhe letërsisë lokale, duke përkrahur botimin e krijimtarive të autorëve lipjanas.

#Kosova16





KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

SKUPŠTINA LIPJAN - MUNICIPALITY OF LIPJAN



Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit të Komunës ka takuar kryetarët e Këshillave Lokal të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit me të cilët kanë diskutuar fuqizimin e rolit të tyre në lokalitet dhe vendbanimet nga ata vijjnë.

Me këtë rast Kryetari z. Ahmeti përveç se ka kërkuar nga kryetarët e këshillave lokal bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet komunale në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve bazuar në prioritet e vendbanimeve të tyre, ai ka njoftuar ata edhe me vendimin e fundit për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.



THIRRJE PËR APLIKIM



Për fermerët e Komunës
së Lipjanit në kuadër të
implementimit të
projektit: subvencionimi
i qumështit për litër

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Komunën e Lipjanit, fton të gjithë fermerët të cilët merren me blegtori që të aplikojnë në kuadër të implementimit të projektit: subvencionimi i qumështit për litër.

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë. Formulari i kompletuar dorëzohet në qendrën për shërbime me qytetarëve në sportelin 1 dhe 2 në Komunën e Lipjanit. Për kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm, shih linkun e bashkangjitur:

[https://kk.rks-
gov.net/.../uploads/sites/20/2024/02/9779.pdf](https://kk.rks.gov.net/.../uploads/sites/20/2024/02/9779.pdf)



Eko-klubi i nxënësve të Gjimnazit “Ulpiana”, në Lipjan, kanë prezantuar rëndësinë e projektit “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” dhe me këtë rast ata kanë shpalosur ndërveprimin e drejtpërdrejtë të rinisë me mjedisin dhe rolin e tyre të rëndësishëm në përmirësimin e gjendjes.

"Mjedisi është pasuria jonë më e çmuar, le të bashkohemi së bashku për ta mbrojtur dhe për ta ruajtur atë për brezat e ardhshëm, çdo veprim i vogël i yni mund të ketë një ndikim të madh, prandaj projekte të tilla të cilat kanë qëllim ruajtjen dhe përkujdesin për mjedisin janë një hap tejet i rëndësishëm drejt një mjedisi më të qëndrueshëm dhe më të pastër për të ardhmen tonë”, ka thënë Nënkryetari Bytyqi.





Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame në Lipjan

Kryetari i Komunës së z. Imri Ahmeti i shoqëruar nga Komandanti i Stacionit Policor Lipjan z. Argjent Gashi, Nënkryetari z. Diamant Bytyqi e Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi kanë vizituar Këshillin e Bashkësisë Islame në Lipjan për të uruar kryetarin Zaim Baftiu për rizgjedhjen në udhëheqjen e KBI-së. Me këtë rast, Kryetari z. Imri Ahmeti përveç që ka uruar rizgjedhjen e z. Baftiu në krye të KBI-së në Lipjan dhe Këshillin e Bashkësisë Islame në Lipjan, ai ka uruar edhe 16 vjetorin e Pavarësisë së Kosovë dhe ka konfirmuar edhe një herë gatishmërinë e tij institucionale për të vazhduar bashkëpunimin dhe mbështetjen ndaj KBI-së.





Nënkryetari Bytyqi bën homazhe për nder të festës së Pavarësisë së Kosovës
Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi së bashku me
bashkëpunëtor, për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, bënë
homazhe dhe vendosën buqeta me lule pranë lapidarit të Komandantit
Legjendar “Adem Jashari”.

Nënkryetari z. Bytyqi para nxënësve të shkollës fillore të mesme të ulët
“Ismail Luma”, theksoi se 17 shkurti është dita kur Kosova u bë shteti më i ri
në kontinentin evropian, prandaj kjo datë do të jetë pjesë e historisë së
kombit shqiptar, i cili ka sakrifikuar shumë gjenerata për të arritur lirinë dhe
pavarësinë e Kosovës.





Për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Komuna e Lipjanit organizon Koncert Festiv

Nën patronatin e kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, mbahet koncert festiv në sheshin e qytetit të Lipjanit “Adem Jashari”.

Gjatë koncertit performuan këngëtarët e mirënjohur si Mahmut Ferati, Riza Bytyqi, Fatbardha Drenogllava dhe Emir Drenogllava, të cilët krijuan një atmosferë fantastike për të gjithë qytetarët e komunës së Lipjanit.

Gëzuar Dita e Pavarësisë së Kosovës!





Nën patronatin e kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës u organizua turneu “Kupa e Pavarësisë”, ku mblodhi qindra sportistë dhe sportiste

Turneu "Kupa e Pavarësisë", ka mbledhur sportistë dhe sportiste, duke sjellë një garë të ngrohtë dhe emocionuese. Shkollat e futbollit për grupmoshat U-11 dhe U-13, si dhe ndeshjet për vajzat U-7, tregojnë se pasioni për sportin është i jashtëzakonshëm në të gjitha grupmoshat.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit dhe organizatorët për një ditë të shkëlqyer sportive në ditën më të rëndësishme të vendit tonë siç është Dita e Pavarësisë së Kosovës.





Kryetari i Komunës së Lipjanit, z.Imri Ahmeti, me bashkëpunëtorët e tij kanë pritur në takim përfaqësues të USAID-it nga projekti “Integriteti i Komunave të Kosovës”, të cilët prezantuan rezultatet e arritura nga Komuna e Lipjanit për vitin 2023 në indikatorët e gradimit për komunat partnere.

Kryetari z.Imri Ahmeti ka falenderuar ekipin e USAID-it për bashkëpunimin dhe asistimin në ndërtimin dhe ngritjen e standardeve të punës në menaxhim sa më efikas dhe sipas këtyre rezultateve që u prezantuan po shifet që ka një progres dhe stabilitet në qeverisjen e fushave që përfshin projekti.





Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, priti në një takim të veçantë nxënësit fitues të garës së ASEF në Tiranë

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti tregojë një ndjenjë të thellë krenarie dhe admirimi për suksesin e nxënësve të shkollave të Lipjanit në garën e ASEF e cila u zhvillua në kryeqytetin e Shqipërisë.

“Sukseset e tyre në fusha të ndryshme janë shembulli më i mirë i talentit, punës dhe përkushtimit të tyre në arsim. Ky sukses i nxënësve tregon përpjekjen dhe aftësitë e tyre të jashtëzakonshme dhe është një dëshmi e qartë se arsimi në Lipjan po prodhon gjenerata të arta të cilat do janë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë”, ka thënë kryetari z. Imri Ahmeti.





Komuna e Lipjanit e gatshme për procesin e regjistrimit të popullsisë

Komisioni Komunal për Regjistrimin e Popullësisë në Komunën e Lipjanit ka zhvilluar takim pune me përfaqësueset e Agjencisë së Statistikave të Kosovës – ASK ku është diskutuar rreth përgatitjeve të nevojshme për Regjistrimin e e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, me theks të veçantë në territorin e komunës sonë.

Me këtë rast, nënkryetari z.Diamant Bytyqi ka shprehur edhe një herë gatishmërinë e Komunës së Lipjanit për përkrahje të plotë për ASK-në në bashkërendimin e aktiviteteve për zhvillimin sa më të mbarë të këtij projekti i cili do të filloj të realizohet në prill të këtij viti.

Nga ana tjetër përfaqësuesit nga ASK prezantuan aktivitetet që rrjedhin nga plani për Regjistrimin e Popullsisë dhe njoftuan për së afërmi Komisionin Komunal për Regjistrim, lidhur me proceset, përgatitjet dhe zhvillimet e reja rreth këtij procesi.

Ditë më parë është publikuar edhe lista finale me mbikëqyrësit e përzgjedhur, të cilët do të jenë të angazhuar në realizimin e projektit të regjistrimit.

Lista Mbikqyrësve:

<https://askapi.rks-gov.net/.../5e0e46c2-f899-4f6b-b681...>

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave do të zhvillohet nga data 05 Prill deri më 17 Maj 2024 në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë për herë të fundit është realizuar në vitin 2011.

[#rekos2024](#)



Kuvendi i Komunës së Lipjanit zhvilloi punimet e mbledhjes së 27-të
Kuvendi i Komunës së Lipjanit udhëhequr nga Kryesuesi, Daut Azemi
ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 27-të me radhë, në të cilën u
aprovuan pikat e rendit të ditës me një pikë shtesë.
Kryetari Imri Ahmeti, së bashku me nënkryetarin Diamant Bytyqi dhe
drejtorët e drejtorive komunale kanë dhënë sqarime në të gjitha
çështjet dhe pyetjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.





Kryetari Imri Ahmeti, prezantoi raportin vjetor të punës

Sot në seancën e 27-të të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti ka prezantuar raportin vjetor të punës për vitin 2023.

Gjatë prezantimit të këtij raporti vjetor, kryetari Ahmeti ka theksuar se vitin që lamë pas kemi arritur që ta përmbyllim me sukses, ashtu edhe qysh e kishim planifikuar në planin tonë të punës.

Në vazhdimësi jemi angazhuar që të gjithë qytetarëve lipjanas t'iu ofrojmë kushte dhe shërbime sa më cilësore.

“Jam mëse i kënaqur me rezultatet e arritur nga Komuna e Lipjanit. Një ndër objektivat kryesore ka qenë transparenca dhe publikimi i të gjitha raporteve lidhur me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, raporteve rreth inkasimit të të hyrave vetanake dhe menaxhimin e pasurisë. Në raportin e fundit të publikuar nga Instituti GAP “Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave”, Komuna e Lipjanit renditet e para për transparencë Buxhetore. Lipjani bën pjesë në kuartilin e lartë me 100 pikë të grumbulluara është renditur si komuna më transparente. Gjithashtu KDI në raportin saj, rendit Lipjanin komunën e dytë më transparente në Kosovë.

Ndërsa në raportin e MAPL-së në projektin DEMOS, Komuna e Lipjanit ka përfituar Grant Përfomance në vlerë 1,843.786.22 €, është shprehur kryetari Ahmeti.


Ai po ashtu ka thënë se edhe këtë vit e hyra vetanake në komunën tonë shënon progres të jashtëzakonshëm duke tejkaluar planifikimin buxhetor, ku deri në fund të vitit (2023) në total e hyra vetanake ka kaluar planifikimin fillestar për 50.69%.

Gjatë prezantimit të këtij raporti, kryetari z. Imri Ahmeti ka shpalosur të gjitha të arriturat e Komunës së Lipjanit në vitin 2023, projektet e realizuara dhe sfidat me të cilat është përballur ekzekutivi komunal gjatë kësaj periudhe raportuese.

“Konsideroj se në aktivitetet tona objektiv e përhershme mbetet qeverisja e ligjshme, transparente dhe llogaridhënëse. Mirëpo çdo herë periudhat raportuese reflektohen edhe me sfida të ndryshme që kemi para vetës”, ka thënë Kryetari Ahmeti mes të tjerash, duke shtuar se pavarësisht sfidave qyteti ynë po rritet, komuna jonë mbetet komuna me progres të jashtëzakonshëm, Lipjani mbetet konkurent i fortë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Do të vazhdoj të angazhohem fort e me përgjegjësi të zhvillojmë vendin tonë, komunën tonë. Mbështetja juaj është determinuese e sukseseve tona.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë